



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development**

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
Duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore
të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010) si dhe
duke u bazuar në Nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 14 të Rregullores nr. 02/2011 për
fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive
(22.03.2011), dhe neni 24 Ligji Nr. 2004/13 për Materialin Fidanor, dt. 28 Maj 2004,
Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2011
Për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MA-NR.03/2007
për regjistrimin e prodhuesve të materialit fidanor

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ bëhet Ndryshim dhe Plotësimi i Udhëzimit
Administrativ MA-NR.03/2007 për regjistrimin e prodhuesve të materialit fidanor, të
datës 14.03.2007.

Neni 2

Neni 3 paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, dhe 3.4 të Udhëzimit Administrativ MA-NR.03/2007
reformulohet si vijon:

Paragrafi 3.1 shuma prej “20€” zëvendësohet me “10€”, teksti tjetër mbetet i njëjtë.

Paragrafi 3.2 shuma prej “20€” zëvendësohet me “10€”, teksti tjetër mbetet i njëjtë.

Paragrafi 3.3 shuma prej “20€” zëvendësohet me “10€”, teksti tjetër mbetet i njëjtë.

Paragrafi 3.4 shuma prej “20€” zëvendësohet me “10€”, teksti tjetër mbetet i njëjtë.

Neni 3

Neni 5 të Udhëzimit Administrativ MA-NR. 03/2007, afati reformulohet si vijon: “3 vite”
zëvendësohet me “1 vit” teksti tjetër mbetet i njëjtë.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë. 29.04.2011

Blerand Stavileci

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Udhëzimi i dërgohet:

- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *DPMB- Divizioni i Hortikulturës, dhe*
- *Arkivit.*